



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.Dh.Shk II.nr.1699/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit Telekom i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë NUI 81128800, kundër debitorit KK Mitrovicë, Drejtoria e Prokurimit, me NRB 90000900, të cilin me autorizim e përfaqëson L.Z. avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2640/22 të datës 29.09.2023, me datë **05.03.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit Telekom i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 2640/22 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 2640/22 të datës 29.09.2023 në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit KK Mitrovicë, Drejtoria e Prokurimit, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.401/22, i datës 02.12.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli të zyrës në Mitrovicë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2640/22 të datës 29.09.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, dhe i njëjti përmes parashtresës ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuara pretendimet ankimore, duke i propozuar gjykatës që të refuzoj si të pa bazuar ankesën e kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Telekom i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë NUI 81128800 me datën 01.12.2022, ka paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshem - Faturës me numër: nr.191031092646.

Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj me seli në Mirovicë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.401/22, i datës 02.12.2022 e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbartimor Debitori, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se fatura (si dokument i besueshëm) mbi bazën e se cilës është iniciuar procedura përmbartimore, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, sepse është e panëshkruar dhe pavulosur nga debitori

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabaza dhe ka theksuar se të njëjtat kanë për qëllim prolongimin e përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga raporti në mes tyre, duke shtuar se ky dokument i plotëson të gjitha kushtet ligjore që të konsiderohet dokumenti i besueshëm, po ashtu në përgjigje ka kundërshtuar pohimet e debitorit se nuk e ka pranuar faturën, pasi që pretendon se e njëjta është dërguar përmes emailit. Nga gjykata kërkoi ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 2640/22 të datës 29.09.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit, ndërsa ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.401/22, i datës 02.12.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli të zyrës në Mitrovicë.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se dokumenti - fatura nr. 191031092646, në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta të jetë pranuar nga debitori. Gjykata vlerëson se e-maili i dërguar nga kreditori tek debitorit nuk është provë e mjaftueshme se fatura është pranuar. Në mungesë të konfirmimit të faturës së pranuar nga debitori përmes emailit që i është dërguar nga kreditori, një pretendim i tillë duhet të refuzohet.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar ne Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”, konsideron se fatura nr. 191031092646, si dokument ne sajë te cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është pranuar nga debitori, njëjta nuk është e vulosur e as nënshkruar nga debitori , ndërsa emaili i dërguar nga kreditori drejtuar debitorit nuk është provë e mjaftueshme pasi që debitori nuk ka konfirmuar pranimin e emailit, andaj, në këtë mënyrë fatura nuk mund konsiderohet si dokument i besueshëm.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**K.Dh.Shk II.nr.1699/23, me datë 05.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Faton Bajrami**